



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:142853
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05688916

Ac.nr.8683/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Faton Ademi e Besnik Feka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.K, Q.K, M.S, F.D, F.T, E.A, B.L dhe B.B, të gjithë nga P..., të cilët me autorizim i përfaqëson A.S- avokat në P..., kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (MASHT) - Prishtinë, me objekt të padisë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e prezencës në punë - shujtat ditore, vlera e objektit të kontestit ,,.....€, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1337/21, të datës 28.10.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datën **15.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (MASHT) - Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1337/21, të datës 28.10.2022, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1337/21, të datës 28.10.2022, në pikën *I (një)* të dispozitivit, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve R.K, Q.K, M.S, F.D, F.T, E.A, B.L dhe B.B, nga P..., dhe ka detyruar të paditurën Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (MASHT), që paditësve:-Për paditësin e parë R.K, që në emër të shujtave ditore për gjithsej 320 ditë pune nga data 18.04.2017 deri në ditën e paraqitjes së padisë (datë 02.07.2021), të ia kompensoj shumën prej 640 € (gjashtëqind e katërdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.07.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 7

(shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. -Për paditësin e dytë Q.K, që në emër të shujtave ditore për gjithsej 209 ditë pune nga data 18.04.2017 deri në ditën e paraqitjes së padisë (datë 02.07.2021), të i'a kompensoj shumën prej 418 € (katërqind e tetëmbëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.07.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. -Për paditësin e tretë M.S, që në emër të shujtave ditore për gjithsej 166 ditë pune nga data 18.04.2017 deri në ditën e paraqitjes së padisë (datë 02.07.2021), të i'a kompensoj shumën prej 332 € (treqind e tridhjetë e dy euro) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.07.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. -Për paditësin e katërt F.D, që në emër të shujtave ditore për gjithsej 312 ditë pune nga data 18.04.2017 deri në ditën e paraqitjes së padisë (datë 02.07.2021), të i'a kompensoj shumën prej 624 € (gjashtëqind e njëzet e katër euro) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.07.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. -Për paditësin e pestë F.T, që në emër të shujtave ditore për gjithsej 195 ditë pune nga data 18.04.2017 deri në ditën e paraqitjes së padisë (datë 02.07.2021), të i'a kompensoj shumën prej 390 € (treqind e nëntëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.07.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. - Për paditësin e gjashtë E.A, që në emër të shujtave ditore për gjithsej 461 ditë pune nga data 18.04.2017 deri në ditën e paraqitjes së padisë (datë 02.07.2021), të i'a kompensoj shumën prej 922 € (nëntëqind e njëzet e dy euro) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.07.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. -Për paditësin e shtatë B.L, që në emër të shujtave ditore për gjithsej 194 ditë pune nga data 18.04.2017 deri në ditën e paraqitjes së padisë (datë 02.07.2021), të i'a kompensoj shumën prej 388 € (treqind e tetëdhjetë e tetë euro) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.07.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. -Për paditësin e tetë B.B, që në emër të shujtave ditore për gjithsej 447 ditë pune nga data 18.04.2017 deri në ditën e paraqitjes së padisë (datë 02.07.2021), të ia kompensoj shumën prej 894 € (tetëqind e nëntëdhjetë e katër euro) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.07.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. Në pikën II (dy) të dispozitivit, e ka detyruar të paditurën Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (MASHT) - Prishtinë, t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurale në shumë të përgjithshme prej 352 (treqind e pesëdhjetë e dy) euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovon ankesën e të paditurës, ta ndryshon aktgjykimin e atakuar dhe ta refuzon kërkesëpadinë e paditësve.

Paditësja ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës, përmes së cilës e ka kundërshtuar të njëjtën, duke propozuar refuzimin e saj dhe vërtetimin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, me datën 02.07.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, me arsyet si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, bazuar në nenin 150 par.1, pika a), b) dhe c) të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1337/2021, të datës 28.10.2022, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se themelësia e kërkesëpadisë së paditësve del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga vërtetimi për marrëdhënien e punës dhe prezencën e ditëve në punë nr. 394/21 për paditësin R.K e datës 14.05.21, vërtetimi për marrëdhënien e punës dhe prezencën e ditëve në punë nr. 393/21 për paditësin Q.K, vërtetimi për marrëdhënien e punës dhe prezencën e ditëve në punë nr. 392/21 për paditësin M.S, vërtetimi për marrëdhënien e punës dhe prezencën e ditëve në punë nr. 391/21 për paditësen F.D, vërtetimi për marrëdhënien e punës dhe prezencën e ditëve në punë nr. 390/21 për paditësin F.T, vërtetimi për marrëdhënien e punës dhe prezencën e ditëve në punë nr. 383/21 për paditësin E.A, vërtetimi për marrëdhënien e punës dhe prezencën e ditëve në punë nr. 388/21 për paditësin B.L dhe vërtetimi për marrëdhënien e punës dhe prezencën e ditëve në punë nr. 387/21 për paditësin B.B, të gjitha këto vërtetime të lëshuara dhe të nënshkruara nga Administratori i SHMLT “11 Marsi” në Prizren. Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e dt.18.04.2017. Vendimin lidhur me kamatën e ka bazuar në nenin 382 të LPK-së nga dita e parashtrimit të padisë, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur e ka marrë në bazë të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të

LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHMLT “11 Marsi” në Prizren, e po ashtu janë vërtetuar edhe ditët e pranisë së paditësve në punë për periudhën për të cilën paditësit kërkojnë kompensimin e ushqimit, përmes vërtetimeve të lëshuar nga institucioni në të cilin punojnë, e të cilët gjenden në shkresat e lëndës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*”.

Me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 parashihet se “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*”. Edhe sa i përket vlerësimit të kohëzgjatjes së kontratës është bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.40/2023, të datës 27.02.2023, ku është theksuar se “*Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 21.01.2021*”. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit,

pasi që me nenin 46, paragrafi 2 të Marrëveshjes Kolektive të Arsimit në Kosovë MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar me nenin 35, paragrafi 5, 7 dhe 9 brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare nuk qëndron pasi që Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të shpenzimeve për shujta i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.), në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, andaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 150 par.1, pika a), b) dhe c) të LPK-së i cili shprehimisht përcakton *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pasi që vlerëson se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmerisë / mosbindjes.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadiës së paditëses që në emër të kompensimit të shujtave ditore, t’iu kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadiës gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është vërtetimi për ditët e pranisë në punë, nga të cilat edhe është vërtetuar saktësisht lartësia e kërkesëpadiës, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për kamatën gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur në pajtim me dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8683/22, datë 15.05.2024

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Arsim Hamzaj**